




Manuali i Përdorimit të Parkingmetrit

Instruksionet e përdorimit



PËR TË PËRDORUR PARKINGMETRIN TISPARK FILLIMISHT SIGUROHUNI QË TË KENI KREDIT TË MJAFTUESHËM PASTAJ NDIQNI HAPAT MË POSHTË:

1. PËR TË NDEZUR PAJISJEN

Shtyp

Në ekran do të shfaqet vlera e mbetur e kreditit për pagesën e parkimit.

KUJDES: Kontrolloni që të keni mjaftueshëm kredi për të paguar gjatë gjithë kohës që dëshironi në bazë të qytetit dhe zonës së parkimit që do vendosni më pas. Nëse krediti juaj ka mbaruar pasi të keni vendosur qytetin dhe zonën në ekran do shfaqet "-----" dhe pajisja do të fiket. Nuk do jetë e mundur ta ndizni sërish derisa të kryhet një rimbushje. Për të ndihmuar përdoruesin që parkon gjithmonë në të njëjtin qytet, pajisja do ta mbajë, mend zgjedhjen tuaj në mënyrë që herës tjetër ju mos të kryeni sërish të njëjtin veprim.

2. ZGJIDHNI QYTETIN

Shtyp përsëri

Në ekran do të shfaqet emri i qytetit ku doni të parkoni.




Me anë të shigjetave lartë  ose poshtë  zgjidhni qytetin ku jeni dhe shtypni sërish  për ta konfirmuar.




KUJDES: Për të ndihmuar përdoruesin që parkon gjithmonë në të njëjtën zonë, pajisja hyn automatikisht në funksionin parkim nëse për disa sekonda nuk shtypet më asnjë buton, duke filluar nga zgjedhja e qytetit.

SHËNIM: Lista e qyteteve të reja rifreskohet automatikisht gjatë çdo rikarikimi. Për informacione të mëtejshme mbi qytetet ku mund të përdoret vizitoni www.tispark.al.

3. ZGJIDHNI ZONËN

Pasi keni zgjedhur qytetin në ekran do të shfaqet kodi i zonës së parkimit. Me anë të shigjetave lartë  ose poshtë  zgjidhni zonën e parkimit dhe shtypni  për ta konfirmuar zgjedhjen.

Nëse shtypni sërish  ose nuk kryheni asnjë veprim për disa sekonda, pajisja kalon në funksion parkimi dhe qyteti sëbashku me zonën do të shfaqet në ekran.

Qe nga ky moment duke nisur nga fillimi i minutit të parë fillon pagesa dhe krediti vjen duke u ulur.




Tarifa të veçanta


TisPark aplikon tarifat e parkimit të përcaktuara nga bashkia ose kompania e shërbimit të parkimit.

KUJDES: Tarifat e reja të miratuara do të rifreskohen në pajisjen tuaj automatikisht gjatë rikarikimit më të parë që ju do të kryeni pas hyrjes në fuqi të tyre. Për më shumë informacion mbi ndryshimin e tarifave vizitoni faqen e internetit www.tispark.al

Koha maksimale

Pasi është zgjedhur zona, nëse ajo ka një orar maksimal të kohës së parkimit në ekran do të shfaqet një ikone ore ose si "Mickey Mouse".

Duke shtypur  shfaqet edhe tarifa e veçantë e cila aplikohet në këtë zonë speciale.

Duke shtypur  - ose pa shtypur asnjë buton për disa sekonda - pajisja hyn në funksionin e parkimit dhe qyteti bashkë me zonën shfaqet në ekran.

KUJDES: Pasi të ketë mbaruar koha maksimale gjatë të cilës lejohet parkimi në zonën e zgjedhur, pajisja do të shfaqë mesazhin EXPT për të treguar që koha maksimale e lejimit të parkimit në këtë zonë ka mbaruar. Kujdes! Në këtë rast jeni duke shkëlur rregullat dhe mund të jeni subjekt i ndëshkimeve përkatëse.

Koha fillestare minimale

Megjithëse pajisja TisPark të lejon pagesë parkimi për minutë ajo i përmbahet tarifave të përcaktuara nga kompania e shërbimit të parkimi. Në rastet në të cilat është e parashikuar pagesa minimale për parkim (për shembull pagesa e detyruar minimale për 20 minutat e para) pagesa minimale do të tarifohet që në minutën e parë.

KUJDES: Për më shumë informacion mbi ndryshimin e tarifave vizitoni faqen e internetit www.tispark.al

Tarifë e ndryshueshme

Nëse zona parashikon tarifë të ndryshueshme në kohë në vend të tarifës orare në ekran do të shkruhet "Var".


KUJDES: Nëse keni bërë ndonjë veprim gabim mjafton ta fikni duke shtypur  dhe ta filloni nga pika 1.


4. VENDOSJA NË AUTOMJETE

Pajisja TisPark rekomandohet të vendoset në xhamin e makinës, e drejtuar nga jashtë, në mënyrë që ekrani të jetë lehtësisht i verifikueshëm nga kontrollorët.

Pajisja e ndezur gjatë parkimit tregon në ekran qytetin dhe zonën e zgjedhur, kohën e mbetur të kreditit (deri në fund të orarit të parkimit me pagesë për zonën) dhe orën aktuale. Pajisja lëshon një "bip" çdo minutë kur është në funksionin e parkimit, e cila është e nevojshme për t'ju kujtuar që ta fikni pajisjen pasi të jeni kthyer në automjet.

5. PËR TË NDËRPRERË PAGESËN E PARKIMIT

Pasi të jeni kthyer në automjet shtypni butonin  për të ndaluar pagesën për parkim.

Pajisja do të fiket dhe do të kryhet automatikisht heqja e vlerës së kreditit nga vlera totale. Në fund të kohës ditore të parkimit me pagesë, pajisja TisPark ndalon së tarifuari për parkimin, pa qënë nevoja të shkoni tek automjeti juaj. Pasi të ktheheni në makinë fikeni pajisjen duke shtypur .

VEPRIME DHE KARAKTERISTIKA TË TJERA LLOGARITJE AUTOMATIKE E NDËRPRERJES SË PAGESËS

Qytetet në të cilat gjatë ditës është parashikuar një ndërprerje e pagesës (shembull: ndërprerje e pagës nga ora 12:30 deri 14:30), TisPark automatikisht ndalon tarifimin gjatë kësaj perjudhe. Gjatë ndërprerjes në ekran shfaqet ikona e "Mickey Mouse". Nuk është nevoja që të ktheheni në automjetin tuaj për të ndaluar pajisjen as për ta rifilluar.

KUJDES: Mos e ndizni pajisjen gjatë ditëve të cilat nuk është parashikuar pagesa për parkimin e automjeteve (për shembull ditë festash) sipas rregullave të çdo qyteti.

AKTIVIZIMI AUTOMATIK I PAJISJES

Nëse doni që pagesa juaj të fillojë automatikisht për parkimin gjatë ditës së ardhshme mjafton ta ndizni atë (nëse është ndezur fiken dhe ri-ndizeni). Pajisja do të fillojë të tarifojë vetëm kur të fillojë orari i parkimit me pagesë (shembull: Nëse parkimi me pagesë mbaron në 18:00 dhe fillon në 8:00, ri-ndizeni pajisjen në çdo moment nga ora 18:00 deri 8:00 të ditës pasardhëse dhe tarifimi do të fillojë në orën 8:00 të ditës pasardhëse).

KUJDES: Pajisja nuk është duke tarifuar vetëm kur në ekran shikoni ikonën e "Mickey Mouse", gjë e cila do të thotë që jeni akoma në orarin e parkimit pa pagesë.

PAGESA PËRTEJ MBARIMIT TË KREDITIT

Gjatë parkimit, edhe pse koha juaj ka mbaruar, por për ndonjë arsye ju nuk keni mundësi të ktheheni në automjetin tuaj, pajisja TisPark ju mundëson një kohë shtesë të vogël duke ju lejuar që të shkoni me minus (maksimumi 30 minuta). Një pajisje e cila është me minus nuk mund të përdoret derisa ajo të rikarrikohet sërish.

KUJDES: Kur të kalohet debiti maksimal prej 30 minutash në ekran do të shfaqet mesazhi EXPM dhe përdoruesi mund të ndëshkohet për parkim të papaguar.

PËR TË RIMBUSHUR PAJISJEN TISPARK

Pajisja mund të rimbushet pranë qendrave të autorizuara ose direkt nga programi i instaluar në kompiuterin tuaj. Për listën e plotë të qendrave të autorizuara ku mund të kryeni rikarikimin e pajisjes, ose mbi instruksionet për rikarikimin online të pajisjes nga kompiuteri personal, vizitoni faqen www.tispark.al Pas çdo rimbushje ju do të pajiseni me faturën e rimbushjes. Gjatë procedurës së rimbushjes lista e qyteteve dhe e tarifave do të rifreskohet automatikisht në pajisjen tuaj. Nëse bëhet një rifreskim i programit do ju kerkohet sërish të zgjidhni qytetin dhe zonën e parkimit (ky rregull i referohet përdoruesve të cilët parkojnë gjithmonë në të njëjtën zonë parkimi).

BATERIA

Pajisja TisPark ushqehet nga një bateri buton normale 3.3V seria cr2032. Bateria është e përfshirë. Për ndërrimin e baterisë së rënë, duhet të blihet një bateri e të njejtit tip. Për të ndërruar baterinë hiqeni mbrojtësen plastike të tejdukshme, kthejeni pajisjen nga mbrapa dhe me anë të një monedhe rrotulloni plastiken e rrumbullaktë qendrore sipas shigjetave. Mbylleni sërish pajisjen dhe shkoni pranë një qendre rimbushje TisPark për ta sinkronizuar orën e pajisjes. Pas ndërrimit të baterisë, problemi i sfazimit të kohës në pajisje mund të kryhet edhe duke lidhur pajisjen me programin në shtëpi, sipas instruksioneve në faqen e internetit. (jo medoemos vetëm në pikat e shitjes së kompanisë).


KUJDES: Pas ndërrimit të baterisë në ekran do të shfaqet mesazhi "SERVZ" i cili ju tregon që duhet të shkoni pranë një qendre rimbushjeje për të sinkronizuar orën e pajisjes.

RIFRESKIMI I TARIFAVE TË PARKIMIT

Në rast ndryshimi të tarifave të parkimit për të evituar masat ndëshkuese drejtoheni menjëherë pranë një qendre rimbushjeje TisPark.

PROBLEME ME PAJISJEN

Pajisja nuk fillon tarifimin.

Si fillim kontrolloni nëse keni kredi të mjaftueshëm. Shtypni butonin  dhe nëse krediti është 0 ose më i vogël drejtoheni pranë një qendre rimbushjeje. Nëse pajisja nuk ndizet fare ka mundësi që bateria të ketë mbaruar dhe si rrjedhim duhet ndryshuar, më pas shkoni pranë një qendre rimbushjeje për të sinkronizuar të dhenat tuaja.

Data dhe ora e pajisjes nuk janë të sakta.

Drejtoheni pranë një qendre rimbushjeje për të sinkronizuar orën.

Mesazhi "SERVZ" në ekran.

Drejtoheni pranë një qendre rimbushjeje për të sinkronizuar të dhenat.

KEQFUNKSIONIMI

Në rast keqfunksionimi të pajisjes, për më shumë informacion na kontaktoni në adresën info@tispark.al ose në numrin e telefonit +355 69 60 60 011 ose paraqituni pranë qendrës së rimbushjes më të afërt.

KUJDES: Kompania TisPark nuk mban përgjegjësi në rast të përdorimit jashtë atyre çka u përshkruan në këtë manual.

Ky manual është i vlefshëm për përdorimin e pajisjes TisPark nga 2015 deri në një rifreskim të ri.

NE MBROJMË AMBJENTIN SIPAS LIGJIT OSE PRAKTIKAVE TË MIRA TË ELEMENIMIT TË PAJISJEVE ELEKTRONIKE

Simboli i koshit me kryq i vendosur sipër pajisjes ose mbi paketimin e pajisjes tregon që produkti në fundin e jetës së tij duhet të mbledhet veçmas nga mbeturinat e tjera. Përdoruesi duhet që në fund të jetës së pajisjes ta eliminojë atë duke e dërguar në qendrat e mbledhjes së pajisjeve elektronike të cilat janë të veçanta nga ato të mbeturinave të zakonshme. Mbledhja e diferencuar e ketyre pajisjeve të cilat kanë aritur në fundin e jetës së tyre, trajtimi dhe riciklimi ndihmon në evitimin e efekteve negative mbi ambjentin dhe mbi shëndetin publik. Gjithashtu favorizohet riciklimi i materjaleve të përdorura për ndërtimin e pajisjes. Hedhja abuzive e produktit nga përdoruesi përbën shkelje.



TIS PARK®

www.tispark.al
info@tispark.al

Për informacion dhe kujdesin ndaj klientit telefononi:

+355696060011